



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS GJERMANE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Teknika të redaktimit dhe të shprehjes

Ngarkesa: 3 kredite; 30 orë mësimore; 30seminare;

Viti / Semestri : Viti I, semestri II

Llojiilëndës: Lëndë e detyrueshme

Programiistudimit: “Master i shkencave” në “Përkthim teknik-letrar dhe interpretim”

Kodi i etikës: Kodi i etikësi UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore: Redaktimi përfshin disa njohuri dhe aftësi specifike (shenjat e redaktimit, teknikat e leximit editorial, llojet e redaktimit etj.).

Studenti duhet: Të përsosë njohuritë në gramatikën e gjuhës gjermane, si dhe të gjuhës shqipe, sidomos në strukturën e tyre. Të thellojë njohuritë në leksikun e gjuhës gjermane dhe të gjuhës shqipe. të arrijë kompetencat e të kuptuarit dhe të argumentuarit për ndryshimet themelore që i duhen bërë një teksti para botimit. të punojë në mënyrë të pavarur .Të thellojë aftësinë për të arritur lidhjen midis formës dhe përmbajtjes së veprës, saktësinë e përdorimit të materialit faktik, përmirësimin e strukturës kompozicionale, qartësinë logjike, hartimin kompetent leksikor leksikor të tekstit

Objektivat specifike lëndore:

1. Të njohë nga ana teorike e praktike procesin e redaktimit në gjuhën gjermane ose tekste të përkthyer në gjuhën shqipe, duke krahasuar me origjinalin në gjermanisht.
2. Të korrigjojë tekstin e shkruar, të eliminojë gabimet drejtshkrimore, të korrigjojë pikësimin, etj. Të jetë i aftë të bëjë ndryshime në hartimin e dokumentit (ndryshimi i fontit, dhëmbëzimit dhe parametrave të tjerë teknikë të tekstit, ndarja në kolona).
3. Të jetë në gjendje të kryejë pa dëmtuar dhe kur është e nevojshme ndryshime objektive thelbësore, strukturore dhe stilistike në tekste para procesi të shtypshkrimit.

Rezultate të pritshme:

1. T'u sigurojë studentëve njohuri dhe aftësi praktike në procesin e redaktimit të teksteve dhe përmirësimin e shprehjes së tyre gjuhësore. Kjo lëndë përqendrohet në teknikat kryesore të rishikimit dhe strukturimit të teksteve, duke përfshirë qasjen ndaj gramatikës, sintaksës, stilistikës dhe qartësisë.
2. Të ndihmojë studentët të zhvillojnë aftësitë e tyre në shkrimin e qartë, të saktë dhe të efektshëm për një gamë të gjerë kontekstesh akademike dhe profesionale. Përmes ushtrimeve praktike dhe diskutimeve teorike, studentët do të mësojnë si të përmirësojnë cilësinë e shkrimit dhe komunikimit të tyre